

REGJISTRI I KERKESAVE DHE PERGJIGJEVE

JANAR – DHJETOR 2023

Nr. Re nd or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkeses	Tarifa
01.	18.01.2023	<p>1. A ju është marr mendim për rishikimin e kufijve të zonës së mbrojtur para miratimit të VKM Nr. 59, date 26.1.2022 “Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore? Nëse po, kopje të mendimeve/opinioneve të dhëna nga institucioni juaj në lidhje me këtë VKM.</p>	18.01.2023	<p>1. Po ju informojmë se në lidhje me kërkesën për informacion nëse është marrë mendim për rishikimin e kufijve të zonës së mbrojtur të cilën e ndryshuan me VKM Nr. 59 date 26.01.2022 , nuk është bërë ndonjë takim me Bashkinë Vau Dejes, me konkretisht me Drejtorinë e Planifikimit Urban.</p>	E plotë	Pa pagesë
02.	18.01.2023	<p>1 .A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2022?</p> <p>2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qene forma e mbeshtetjes (grant, kontrata sherbirmi, prokurim publik/tenderim, etj.).</p>	31.01.2023	<p>1. Bashkia Vau Dejes ka ofruar mbështetje për shoqatat lidhur me aktivitetet sportive . Organizimi është bërë ndërmjet Metodologjise LOD, ku cdo gjë është bërë publike në faqen WEB të bashkisë .</p> <p>2.Forma e mbështetjes së bashkisë është kontrata e shërbimit.</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>3.Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare gjatë vitit 2022? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë se një formë.</p> <p>4. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur me shumë se një formë.</p> <p>5.Cila ka qene buxheti i disbursuar per organizate dhe ne total? Ju lutem, specifikoni sipas formes nese ka patur me shume se nje formë.</p> <p>6. Keni ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2022? Cila është baza ligjore/rregullatore që rregullon këtë formë mbështetjeje?</p> <p>7. Nëse keni ofruar mbështetje jofinanciare, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qënë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)?</p>		<p>3. Lidhur me thirrjen e Bashkisë Vau Dejes , kanë aplikuar 3(tre) shoqata sportive, për 3 (tre) qëllime të ndryshme</p> <p>4.Nga kjo mbështetje kanë përfituar të treja shoqatat që kanë aplikuar. Aktualisht bashkia ka lidhur kontratën e shërbimit me këto shoqata por nuk ka kaluar akoma fondin</p> <p>5. Fondi që do disbursohet ndërmjet 3 shoqata fituese është në total 3.160.928 lek. Fond i cili do të ndahet sipas aplikimeve, konkretisht për 2 (dy) shoqata nga 580.464 lek, ndërsa 1 (nje) shoqata tjetër në vlerën 2.000.000 lek.</p> <p>6/7. Bashkia Vau Dejes nuk ka ofruar mbeshtetje jofinanciare gjatë vitit 2022.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

	<p>8. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2022?</p> <p>9. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultirnin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.</p> <p>10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.</p> <p>11. Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga Institucioni juaj?</p> <p>12. Sa përqind (%) e projektligjeve/akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-të?</p> <p>13. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshirë në to?</p> <p>14. A janë përfshirë OJF në grupet e punës së ngritura të institucionit tuaj? Nëse PO, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshirë në to?</p>		<p>8. Sa i përket konsultimeve publike gjatë vitit 2022 Këshilli Bashkiak Vau Dejes ka realizuar 34 konsultime me publikun</p> <p>9. Bashkia Vau Dejes nuk ka koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik.</p> <p>10. Bashkia Vau Dejes nuk ka koordinator për shoqërinë civile.</p> <p>11. Nga konsultimet publike të realizuara nga këshilli bashkiak ka marrë pjesë vetëm 1 (një) OJF (Rreze Shprese).</p> <p>12. Sa i përket akteve ligjore, nuk kemi asnjë akt ligjor/nënligjor të hartuar si rezultat i konsultimeve me OJF.</p> <p>13. Në organet këshillimore të Bashkisë Vau Dejes nuk ka asnjë përfaqësues të OJF-ve.</p> <p>14. Po janë përfshi në komisionin social të strehimit dhe janë 2 (dy) , Gruaja tek Gruaja dhe Hapat e Lehtë !</p>		
--	---	--	---	--	--

		<p>15. A është trajnuar stafi juaj mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve? Nëse po, sa punonjës janë trajnuar?</p> <p>16. A ka liçensuar institucioni juaj OJF që ofrojnë shërbime të caktuara? Nëse po, sa OJF janë liçensuar? Për çfarë shërbimesh janë liçensuar?</p>		<p>15. Sa i përket kësaj pyetjeje për trajnime, jo nuk kemi marr trajnime.</p> <p>16. Bashkia Vau Dejes nuk ka liçensuar asnjë OJF .</p>		
03.	14.02.2023	<p>1. Informacion mbi përshkrimin e Bashkisë Vau i Dejës, duke përfshirë një prezantim të historisë, demografisë, ekonomisë, rinisë dhe kulturës së vendit.</p> <p>2. Informacion mbi dokumentet strategjike, ose planet vendore të veprimit, që disponon Bashkia Vau i Dejës. Kërkoj të njoh në mënyre të shkurtër qëllimin e tyre dhe se si prekin rininë nga ato.</p>	22.02.2023	<p>1. Ju bëjmë me dije se informacionin për përshkrimin e bashkisë mund ta gjeni në linkun https://www.vaudejes.gov.al/historia-e-bashkise/ si dhe për çdo informacion tjetër në faqen zyrtare të bashkisë në web https://www.vaudejes.gov.al/</p> <p>2. Sa i përket pyetjes ,më poshtë gjeni dokumentat e publikuara në faqen zyrtare të AKPT, PPV Bashkia Vau Dejes. Të cilat janë të hapura dhe të aksesueshme për këdo.</p> <p>https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>3. Informacion mbi buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës për vitin aktual dhe vitet e planifikuara. Kërkoj të njoh në mënyre specifike cilat janë fondet në përqindje dhe aktivitetet e parashikuara për rininë, si dhe sa është parashikuar të jetë shuma e tyre në buxhet.</p>		<p>3. Ju informojmë që në buxhetin e bashkisë Vau Dejës për vitin 2023 të miratuar me vendimin nr. 84 (të cilin mund ta gjeni në linkun: https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2023/01/vendimi-84_compressed.pdf), rinia është përfituese e disa prej shërbimeve apo investimeve në mënyrë indirekte ku është e pamundur të ndahen se sa prej tyre është në shërbim të rinisë apo pjesës tjetër të shoqërisë në Bashkinë Vau Dejës (psh. Rikonstruksioni i një rruge, ndriçimi në një lagje, etj.)</p> <p>Ndërsa si përfitues direkt për rininë në buxhetin e vitit 2023 është miratuar fondi prej 5 697 000 lekë i cili konsiston në zërat mbështetje financiare për klubet sportive si dhe festivale të ndryshme. Ky fond zë 1.02% nga buxheti total i Bashkisë Vau Dejës.</p>		
04.	14.02.2023	<p>1. Informacion mbi investimet dhe aktivitetet që keni realizuar, për moshën 15-29 vjeç (sipas Ligj 75/2019 "Për rininë", Nëni 3, germa F) gjatë vitit 2021-2022 në fushën: 1. Arsimit dhe edukimit jo-formal: investimeve infrastrukturore dhe fushave sportive; investimeve në laboratore mesimore, aktivitete të edukimit jo-</p>	24.02.2023	<p>1. Përsa i përket kërkesës për informacion për pjesën e investimeve infrastrukturore (arsim dhe edukim informal) që përfshin moshat 15-29 vjeç për vitin 2021-2022 nuk ka patur gjatë këtij viti. Nga sektori i mjedisit në bashkëpunim me shkollat janë ndërmarrë iniciativa për mbrojtjen e mjedisit ku</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>formal, mbështetjen e nxënësve ekselentë, etj. 2. Pjesëmarrje e rinisë në politikë dhe vendimarrje: aktivitete të realizuara për fuqizimin e rinisë në vendimarrje dhe në politikë, pjesëmarrje e rinisë në mbledhjet e këshillit bashkiak etj. 3. Nxitjes së punësimit dhe sipërmarrjes rinore: mbështetjës dhe subvencionim të të rinjve në sipërmarrje, ndërmjetësim dhe informim për punësim, etj. 4. Artit, kulturës, sportit dhe mjedisit: investim në mbështetjen e artistëve të rinj, të sportistëve të rinj, iniciativa për mbrojtjen e mjedisit, etj. 5. Çështjeve sociale, shëndetësore dhe shërbimeve publike për rininë: aktivitete ndërgjegjësuese për çështje sociale dhe shëndetësore etj.</p> <p>Informacioni i kërkuar mbi zbatueshmërinë e ligjit është:-A ka strategji për rininë në Bashkinë tuaj?-A është ngritur Këshilli Vendor i Rinisë?- A ka Bashkia juaj një Qendër Rinore apo hapësirë dedikuar rinisë? - A ka strukturë të dedikuar për rininë në Bashkinë tuaj? -A ka zë të dedikuar buxhetor për rininë? -A janë realizuar në bashkinë tuaj analizim apo raportim mbi situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre? -A ka aplikuar Bashkia për tu mbështetur nga programet kombëtare (p.sh. thirrjet e Agjencisë Kombëtare të</p>		<p>janë bërë fushata pastrimi në lagjet e qytetit dhe në bregun e liqenit Vau Dejës. Sa i përket angazhimit të rinisë në vendimarrje ju bëjmë me dije se në konsultimet publike që zhvillohen nga ana e Këshillit Bashkiak marrin pjesë aktive rreth 40 % të rinj por kjo është relative. Për të garantuar pjesëmarrjen e rinisë në konsultime kemi përdorur njoftimet në vende publike, rrjetet sociale, WEB-in e Bashkisë, takimet e përditshme etj.</p> <p>Në lidhje me informacion për aktivitetet e realizuara në fushën e arsimit, rinisë dhe sportit sipas programit të vetëqeverisjes për Këshillin Vendor Rinor, ju informojmë se duke qënë se në Bashkinë tonë nuk kemi akoma të formuar një Këshill Vendor Rinor, të gjitha këto pika të kërkuara mbetën në kuadrin e parashikimeve tona për një plan në të ardhmen.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

		Rinisë) apo ato ndërkombëtare? Nëse PO, cilat janë ato? Nëse JO, cila është arsya?-A keni realizuar marrëveshje bashkëpunimi për zbatimin e detyrimeve në kuadër të këtij ligji, me organizata të shoqërisë civile, etj.				
05.	20.04.2023	<p>1- Sa është numri i kontratave të lidhura nga Bashkia Vau-Dejës për dhëniën me qira të tokave të administruara prej saj me kompanitë private të cilat kanë fituar licensat për ndërtimin, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve fotofolkaike dhe parqeve eolike në Bashkinë Vau-Dejës.</p> <p>2- Një kopje të kontratave të lidhura nga Bashkia Vau-Dejës për dhëniën me qira të tokave të administruara prej saj me kompanitë private të cilat kanë fituar licensat për ndërtimin, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve fotofolkaike dhe parqeve eolike në Bashkinë Vau-Dejës.</p> <p>3- Një kopje të kërkesave që janë depozituar në Bashkinë Fier për marrjen e tokave me qira nga shoqëritë të cilat kërkojnë të zhvillojnë projekte për ndërtimet e centraleve fotovoltaike dhe parqeve eolike në BashkinëVau-Dejës.</p>	03.05.2023	Po ju informojmë që në Bashkinë Vau Dejës, nuk ka kontrata të lidhura për dhëniën me qira të tokave të administruara prej saj me kompanitë private të cilat kanë fituar licensat për ndërtimin, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve fotofolkaike dhe parqeve eolike në Bashkinë Vau-Dejës. Ndërsa, janë lidhur dy kontrata “ Për dhëniën në përdorim të fondit pyjor/kullosor” për park fotovoltaike , me subjektin Green Energy Generation dhe Lodi Energy shpk, sipas procedurave ligjore të parashikuara nga aktet ligjore në fuqi, konkretisht Ligji nr 57/2020 “ Për pyjet”, Ligji nr 9693 datë 19.03.2007 “ Për fondin kullosor” i ndryshuar; VKM nr 559, datë 29.07.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhëniën në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” dhe vendimet e Këshillit	E plotë	Pa pagesë

				<p>Bashkiak.</p> <p>Gjithashtu, ju informojmë që i gjithë informacioni lidhur procedurat e dhënies së pronave me qira për këtë qëllim dhe qëllime të tjera, është i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Vau Dejës, www.vaudejes.gov.al.</p> <p>Ndërsa, i gjithë informacioni lidhur me subjektet fituese për këtë rast dhe raste të tjera, mund ta gjeni të publikuar pranë faqes zyrtare të app.gov.al (buletinet).</p>		
06.	05.05.2023	<p>1.Neni 7, pika 1/b, i Ligjit për Rininë, parashikon për NJVV-të krijimin e Këshillit Vendor të Rinisë. Aktualisht në cilën fazë është procesi i themelimit të këtij këshilli në bashkinë tuaj? <i>(Është ngritur, është në proces administrativ për tu ngritur, apo është në plan për tu ngritur?)</i></p> <p>2.Nëse Këshilli Vendor Rinor (KVR) është ngritur, ju lutemi informoni mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përbërjen e tij (anëtarësinë përfshirë dhe organizatat që të rinjtë përfaqësojnë); -Nëse janë realizuar mbledhje dhe sa të tilla që prej ngritjes së KVR-së. <p>3.Neni 7, pika 1/c parashikon organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendorë në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve. Në këtë kuadër:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në bashkinë tuaj a ka dokument lokal strategjik për rininë <i>(plan strategjik; strategji; apo çdo dokument</i> 	10.05.2023	<p>1.Lidhur me informacionin e kërkuar për Kongresin Rinor Kombëtar dhe krijimin e Këshillit Rinor Vendorë në Bashkinë Vau Dejës, ju bëjmë me dije se duke qënë së në Bashkinë tonë nuk kemi akoma të formuar një Këshillë Vendor Rinor, rrjedhimisht edhe përgjigjet e kërkuara janë të cinguara dhe jo efikase për pyetëtorin.</p>	E plotë	Pa pagesë

	<p><i>tjeter ku bashkia paraqet objektiva vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve’?</i></p> <p>-Nëse po, a është i publikuar në faqen e Bashkisë? <i>(Do vlerësonim nëse referoni ku konkretisht)</i></p> <p>-Nëse jo, a ka një plan në bashki që parashikon përmbushjen e ligjit në lidhje me këtë pikë?</p> <p>4.Neni 7, pika 1/dh, parashikon financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta.</p> <p>-Në PBA aktuale a ka zë/zëra të dedikuar për këtë çështje në bashkinë tuaj?</p> <p>-Nëse po ju lutem specifikoni programin buxhetor përkatës në PBA 2023-2025.</p> <p>5.Neni 7, pika 1/e, parashikon krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë.</p> <p>-A ka një strukturë administrative për çështjet e rinisë në organikën e aparatit të bashkisë suaj?</p> <p>-Nëse po, ju lutemi të specifikoni:</p> <p><i>*njësinë (drejtorinë/sektorin/ etj.);</i></p> <p><i>*të dhënat e pikës së kontaktit/punonjësit rinor që mbulon çështjet e rinisë: Emër mbiemër, email zyrtar.</i></p> <p><i>*Si dhe informacion nëse kjo pikë kontakti ka në përshkrim pune vetëm mbulimin e çështjeve rinore apo dhe përgjegjësi/fusha të tjera.</i></p> <p>6.Neni 7, pika 1/ë, përmend parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore.</p>				
--	---	--	--	--	--

		<p>-A ka parashikuar bashkia juaj zë të dedikuar në PBA 2023-2025 për këtë çështje?</p> <p>-Nëse po, ju lutem specifikoni programin buxhetor.</p> <p>7.Neni 7, pika 1/f parashikon mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.</p> <p>-A e realizon bashkia juaj këtë detyrim?</p> <p>-Nëse po ju lutemi të referoni raste specifike.</p> <p>8.A ka institucioni juaj një databazë të organizatave rinore/për të rinjtë që operojnë në bashkinë tuaj?</p> <p>9.A bashkëpunoni me organizata të shoqërisë civile për çështjet rinore (si përshtetjet nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre)?</p> <p>10.Si do ta vlerësonit këtë bashkëpunim?</p> <p>11.Neni 7.pika 4 parashikon se Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimit në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>-Keni raste bashkëpunimi të këtij kuadri?</p> <p>12.A jeni angazhuar në realizimin e masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029 për Bashkitë? Nëse po, ju lutemi të paraqisni informacion në çfarë faze është ky proces.</p>			
--	--	---	--	--	--

07.	12.05.2023	<p>1. Si është i organizuar shërbimi veterinar në bashkinë tuaj?</p> <p>2. Sa veteriner janë në strukturën e shërbimit veterinar?</p> <p>3. Sa është fondi i përcaktuar në buxhet për shërbimin veterinar në 5 vitet e fundit (specifikojeni sipas secilit vit)?</p> <p>4. A keni hartuar program pune të profilaksisë veterinare në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si edhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre? - Nëse po, na e vendosni në dispozicion;</p> <p>5. A i keni identifikuar qentë dhe macet e rrugës në territorin që administroni? - Nëse po, sa është numri i tyre në 5 vitet e fundit? (nëse i keni të ndara sipas muajve, njësi administrative, ju lutem specifikojeni);</p> <p>6. Si e organizoni sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve dhe të maceve të rrugës?</p> <p>7. Si i grumbulloni qentë dhe macet e rrugës?</p> <p>8. A keni vende të posaçme, të miratuara, në të cilat i dërgoni?</p> <p>9. Në cilat raste realizoni eliminimin e qenve dhe të maceve të rrugës dhe si e realizoni procesin? - Nëse i keni eliminuar ato për arsye të do të listoni, ju lutemi na informoni për numrin e qenve dhe maceve të eliminuar në 5 vitet e fundit (specifikojini sipas secilit vit);</p> <p>10. A keni konstatuar raste ku ka pasur braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës dhe çfarë masash keni marrë?</p> <p>11. Çfarë masash keni marrë që në ambientet publike, si: rrugë, parqe, kënde lojërash etj., kafshët e shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit</p>	22.05.2023	<p>1. Po ju informojmë që në Bashkinë Vau Dejës aktualisht nuk ka një sektor për shërbimin veterinar të parashikuar në strukturën organizative për vitet 2021, 2022 dhe 2023. Në vitet 2018, 2019, 2020 ka ekzistuar sektori i veterinarisë dhe nga komunikimi me punonjësen e cila ka qënë në sektorin e veterinarisë deri në vitin 2020 janë bërë disa përpjekje për realizimin e këtyre detyrave por pa rezultat, pasi nuk është bërë asgjë konkrete. Sa i përket fondit të përcaktuar në buxhet ju informojmë që institucioni ynë ka parashikuar fond për “Sterilizimin e kafshëve” në 5 vitet e fundit sipas tabelës më poshtë:</p> <table data-bbox="847 1325 1110 1535"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Vlera lekë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2020</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2021</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>2022</td> <td>300 000</td> </tr> <tr> <td>2023</td> <td>300 000</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Vlera lekë	2019	0	2020	0	2021	0	2022	300 000	2023	300 000	E plotë	Pa pagesë
Viti	Vlera lekë																	
2019	0																	
2020	0																	
2021	0																	
2022	300 000																	
2023	300 000																	

		<p>ose për kafshët e tjera?</p> <p>12. Çfarë masash keni marrë për të vendosur dhe për të zbatuar në territorin që administroni, detyrimin për pronarët që të vendosin maskën mbrojtëse në gojë për qentë e shoqërimit të racave agresive gjatë qëndrimit të tyre në ambientet publike?</p> <p>13. A keni konstatuar raste të helmimit të qenve dhe të maceve të rrugës? - Nëse po, si keni vepruar në këto raste?</p> <p>14. A keni referuar tek autoritetet ligjzbatuese raste të braktisjes, helmimit apo të vrasjes së qenve apo të maceve të rrugës? - Nëse po, na informoni për secilin rast;</p> <p>15. A keni informacion për sjelljen e maceve dhe kafshëve të rrugës nga territore të tjera të vendit në territorin e bashkisë suaj?</p> <p>16. A keni marrë ankesa për mënyrën se si e menaxhoni situatën e maceve dhe të qenve të rrugës? - Nëse po, na informoni për numrin e tyre në 5 vitet e fundit;</p> <p>17. A keni ngritur qendra vaksinimi, kastrimi dhe sterilizimi për macet dhe qentë e rrugës? Nëse po, na informoni për adresat e tyre dhe numrin e kafshëve të trajtuara, matrikulluara në 5 vitet e fundit, ndarë sipas kategorive, qen, mace, moshë, tipologjia, etj.;</p> <p>18. A keni qendra të ngritura për macet dhe qentë e rrugës? - Nëse po, si funksionojnë ato, a janë të përkohshme, të përhershme etj.? - Si mundën qytetarët t'i vizitojnë qendrat tuaja dhe si e siguronit transparencën për punën tuaj?</p> <p>19. A keni strehëza të përhershme të ngritura për macet dhe qentë e rrugës që janë në pritje të adoptimit? -</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		Nëse po, si funksionojnë ato? 20. Si funksionon adpotimi i qenve dhe i maceve të rrugës që ju i grumbulloni në territorin tuaj, nëse e ofroni këtë shërbim?				
08.	04.07.2023	<p>-Sa është numri i punësimeve të reja nisur nga 31 Maji 2022 e deri më 31 Maj 2023 (të ndarë sipas kontratave të punësimit, i përhershëm dhe i përkohshëm)?</p> <p>-Në cilat pozicione janë emëruar të punësuarit gjatë periudhës kohore 31 Maj 2022-31 Maj 2023?</p> <p>-Sa është numri i punonjësve, pjesë e Bashkisë dhe institucioneve në varësi në fund të muajit Maj 2023.</p>	13.07.2023	<p>-Nga data 31.05.2022 deri me datë 31.05.2023, në Bashkinë Vau Dejes janë bërë 49 emëtime të reja , përkatësisht 24 me kontratë të përhershme dhe 25 me kontratë të përkohshme. Nga data 31.05.2022 deri me datë 31.05.2023, në Ndërkomunale Bushat janë bërë 3 punësime të reja gjatë kësaj periudhe. Nga data 31.05.2022 deri me datë 31.05.2023, në Zadrina Agrikulturë nuk ka asnjë të punësuar gjatë kësaj periudhe.</p> <p>-Të punësuarit në Bashki gjatë kësaj periudhe janë emëruar në pozicione vakante, përkatësisht 19 punonjës administrate , 7 edukatore kopshti dhe 23 punëtor mirëmbajtjeje dhe shërbimi. Të punësuarit tek Nderkomule Bushat janë të emëruar në pozicionet: Pastrues për pjesët e jashtme, Sanitar dhe Nënpunës peshoreje.</p> <p>-Numri i punonjësve të Bashkisë Vau Dejes në fund të muajit Maj 2023 është 363. Numri i punonjësve të Ndërkomunale Bushat në</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>-Kërkojmë që të na vihet në dispozicion vendimi i emërimeve në detyrë për të gjithë të punësuarit me kohë të plotë apo të pjesshme, direkt në organigramën e bashkisë apo institucioneve në varësi gjatë periudhës kohore 31 Maj 2022-31 Maj 2023.</p>		<p>fund të muajit Maj 2023 është 12. Numri i punonjësve të Zadrima Agrikulture në fund të muajit Maj 2023 është 1.</p> <p>-Në lidhje me pikën e fundit të kërkesës tuaj , mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për Mbrojtjen e te Dhenave Personale” i ndryshuar ,nuk mund t’ju vëmë në dispozicion informacionin e kërkuar pasi përmbajnë të dhëna personale të punonjësve.</p>		
09.	08.07.2023	<p>1.A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor të planifikuar për rininë (grup moshen 15-29 vjec) për periudhën janar-dhjetor 2022? Nese po, sa perqind te shurnes totale te buxhetit zene keto zera? Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka nje planifikim te tille?</p> <p>2. A ka të punësuar pranë Bashkisë suaj individe të moshës 18-29 vjec (përfshirë drejtuesit)? Sa prej tyre janë femra dhe sa meshkuj?</p> <p>3. Sa eshte perqindja e te rinjve (18-29 vjec) te punesuar krahasuar me numrin total te administrates?</p> <p>4. Aka Bashkiajuaj politika rinore te zhvillura specifikisht per grup moshen 15-29 vjec? Nese po</p>	18.07.2023	<p>1.Lidhur me pyetjen mbi buxhetin vjetor të planifikuar për rininë (grupmosha 15-19 vjec) për periudhën janar-dhjetor 2022 ju bëjmë me dije se nuk ka pasur parashikim dhe as ndonjë shpenzim në lidhje me këtë emërtim në buxhet për vitin 2022.</p> <p>2.Sa i përket individëve të moshës 18-29 vjec të punësuar në Bashkinë Vau Dejes ju informojmë se janë 44 (dyzet e katër) femra dhe 23(njëzet e tre) meshkuj.</p> <p>4.Ndërsa sa i përket pyetjeve për të gjitha praktikat lidhur me Politikën Rinore , ju informojmë se për sa kohë</p>	E plotë	Pa pagesë

		<p>a mund te na dergoni nje kopje te tyre? Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka te zhvilluar nje politike te tille?</p> <p>5. A keni ne institucionin tuaj struktura pergjegjese per politikat rinore? Nese po, cilat jane ato (psh. drejtori, sektore, specialiste, struktura perfaqesimi rinor politike etj) dhe prej sa kohesh jane funksionale?</p> <p>6. A ka struktura rinore te ngritura ne Bashkine tuaj dedikuar grupmoshes se te rinjve 15-29 vjec (qendra/zyra rinore, keshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) per periudhen janar - dhjetor 2022. Nese po, cilat jane ato?</p> <p>7. Me ke keni bashkepunuar per ngritjen e strukturave te tilla (organizata rinore, grupe te rinjsh, individe, etj)</p> <p>8. A keni pasur ju forma te tjera bashkepunimit (me grupe te rinjsh, organizata rinore, etj) per zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinine? Nese po ku kane konsistuar ato?</p> <p>9. Sa eshte me përafërsi pjesëmarrja e të rinjve ne konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia? Cilat jane disa nga mjetet apo mekanizmat qe perdor bashkia ne perfshirjen e te rinjve ne te tilla procese?</p>		<p>nuk kemi të formuar një Këshill Rinor në Bashkinë tonë, përgjigjet e pyetësoreve nuk janë të evidentueshme.</p> <p>9.Në konsultimet publike të zhvilluara nga Këshilli Bashkiak, përafërsisht pjesëmarrja e të rinjve është rreth 20-30% e pjesëmarrësve. Si mekanizëm është përdorur njoftimi publik dhe njoftimi nëpërmjet rrjeteve sociale.</p>		
--	--	---	--	---	--	--

10.	17.07.2023	1.Sa është numri i nxënësve të minoritetit Rom/Egjiptian që kanë përfituar bursë sipas VKM Nr.666 të ndryshuar pika 2.1 e të ndarë sipas nivelit (klasa 1-9) për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023?	20.07.2023	1.Sa l përket numrit të nxënësve Rom dhe Egjiptian dhe bursave që përfitojnë në bazë të VKM nr.666 të ndryshuar.(klasa 1-9) , ju informojmë se në Bashkinë Vau Dejës nuk kemi nxënës të komunitetit Rom dhe Egjiptian që frekuentojnë shkollat. Gjithashtu ju vëmë në dijeni se Bashkia Vau Dejës trajton vetëm nxënësit e Arsimit të Mesëm Profesional.	E plotë	Pa pagesë
11.	28.07.2023	1.Sa është numri total i familjeve/individëve që trajtohen me ndihmë ekonomike. 2. Sa është numri total i familjeve që përfitojnë nga ndihma bllok 6%?	31.07.2023	1.Aktualisht në Bashkinë Vau Dejes trajtohen me ndihmë ekonomike 1075 familje. 2. Aktualisht në Bashkinë Vau Dejes nga fondi i kushtezuar 6% trajtohen 138 familje.	E plotë	Pa pagesë
12.	11.08.2023	1.Sa është numri i Kopshteve dhe Çerdheve në bashkinë Përmet? 2.Sa nga këto Kopshte dhe Çerdhe janë me ushqim?	21.08.2023	1. Lidhur me informacionin e kërkuar për kopshtet dhe çerdhet në Bashkinë Vau Dejes ju informojmë se kemi 20 kopshte total. Sa l përket çerdheve nuk kemi ende një çerdhe nën juridiksionin e Bashkisë Vau Dejës. 2.Të gjithë kopshtet janë pa ushqim.	E plotë	Pa pagesë

		<p>3.Sa është numri i fëmijëve përfitues nga ushqimi në Çerdhe gjatë vitit?</p> <p>4.Sa është kosto e ushqimit për Çerdhet në një vit?</p> <p>5.A paguajnë prindërit e fëmijëve tarifë ditore për ushqimin e fëmijëve?</p> <p>6.A ka konvikt në bashkinë tuaj?</p> <p>7.Sa është numëri i nxënësve në konviktin bashkiak?</p> <p>8.Sa është tarifa vjetore e qirasë që paguajnë nxënësit?</p> <p>9.A ofron ushqim konvikti për nxënësit?</p> <p>10.Sa është kostoja vjetore e ushqimit për nxënësit?</p>		<p>3,4,5. Duke qënë se nën juridiksionin e Bashkisë Vau Dejes nuk kemi asnjë çerdhe rrjellimisht nuk kemi përgjigje për pyetjet e mësipërme.</p> <p>6.Po në Bashkinë Vau Dejes ka konvikt.</p> <p>7. Numri I nxënësve në konviktin është 18.</p> <p>8. Sa I përket tarifës vjetore nxënësit nuk paguajnë asnjë tarifë</p> <p>9. Po , konvikti ofron ushqim për nxënësit.</p> <p>10. Për student në konvikt, kostoja vjetore është sipas VKM 666 dhe është 61.799 lekë.</p>		
13.	01.09.2023	<p>Cilët janë emrat e ish kryetarëve të bashkisë suaj nga 1992 dhe në vazhdim si edhe të kryetarit aktual.</p> <p>Ish kryetarëve të komunave nga 1992 deri në 2015 si edhe listat e personave që janë të komanduar në</p>	12.09.2023	<p>- Ish-kryetarët e Komunës Vau Dejës janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zef Mardoda(1992-1996) 2. Nard Ndoka(1996-2000) <p>Ish-kryetarët e Komunës Bushat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Tom Game(1996-2003) 2. Zef Hila(2003-2015) 	E plotë	Pa pagesë

		<p>njesitë administrative të bashkisë suaj .</p>		<p>Ish-kryetarët e Komunës Barbullush janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dede Çaushti(1992-1996) 2. Zef Hila(1996-2003) <p>Ish-kryetarët e Komunës Hajmel janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zef Vokrri(1992-2007) 2. Leke Biba(2007-2015) <p>Ish-kryetarët e Komunës Vig Mnelë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndue Vathi(1992-1996) 2. Pjeter Lleshi(1996-2015) <p>Ish-kryetarët e Komunës Shllak janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bardhok Zhuri(1992-1996) 2. Hil Kodra(2007-2015) <p>Ish-kryetarët e Komunës Temal janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Geg Nika(1996-2000) 2. Mark Zhuri(2000-2015) <p>Në vitin 2000 Vau Dejësi është shpallur qytet (bashki), përkatësisht me këto ish-kryetarë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rrok Lorja(2000-2003) 2. Ded Dodani(2003-2007) 3. Gjon Marku(2007-2015) <p>Në vitin 2015 është bërë bashkimi i Komunave në një Bashki, me këto ish-kryetarë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zef Hila(2015-2019) 2. Mark Babani(2019-2023) 3. Kristian Shkreli(Kryetari aktual i Bashkisë Vau Dejës) <p>Sqarim: Komunitetet Bushat dhe Barbullush kanë qenë të bashkuara në vitet 1992-1996,</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				janë ndarë në vitet 1996-2003, dhe janë bashkuar përsëri në vitet 2003-2015. Ndërsa komunat Shllak dhe Temal kanë qenë të bashkuara në vitet 1992-2007.		
14.	16.10.2023	Informacion mbi bashkepunimet e realizuara nga Bashkia juaj me njësi vendore jashtë Shqipërisë.(kumuna,provinc a,rajone etj.)	23.10.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr,6496 prot. data 16.10.2023 dhe bazuar në informacionin që ka sektori i Integritimit Evropian ,nuk ka asnjë bashkëpunim të realizuar të Bashkisë Vau Dejës me njësi vendore jashtë Shqipërisë.	E plotë	Pa pagesë
15.	28.12.2023	Sa është shuma e paguar për konsumin e energjisë elektrike për institucionin tuaj për periudhën 01.10.2021 – 20.10.2023? (të ndara sipas muajve)	10.01.2024	<p>Viti 2021</p> <p>Tetor 862,881</p> <p>Nëntor 1,264,874</p> <p>Dhjetor 1,190,740</p> <p>Viti 2022</p> <p>Janar 1,178,315</p> <p>Shkurt 1,320,777</p> <p>Mars 1,424,867</p> <p>Prill 1,188,084</p> <p>Maj 1,233,856</p> <p>Qeshor 1,174,103</p> <p>Korrik 1,318,304</p> <p>Gusht 1,047,298</p> <p>Shtator 1,168,883</p> <p>Tetor 1,286,778</p> <p>Nëntor 1,444,386</p> <p>Dhjetor 1,480,235</p> <p>Viti 2023</p> <p>Janar 1,264,823</p> <p>Shkurt 1,362,409</p> <p>Mars 1,238,820</p> <p>Prill 1,240,126</p> <p>Maj 999,121</p> <p>Qeshor 865,404</p> <p>Korrik 741,902</p> <p>Gusht 795,600</p> <p>Shtator 994,923</p> <p>Tetor 1,470,376</p>	E plotë	Pa pagesë

